



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1590 Prot.

Roskovec, më 01.03 2021

VENDIM

NR 10 .DATË 26.07 .2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 68, DATË 28.08.2020 "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "PËR NDËRTIMIN E BANESAVE PËR STREHIM SOCIAL, ROSKOVEC"

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 1.2 germa b; ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" nenet 7; 8 germa ç; 9/1; 10 pika 1 germa c; 11; 17 dhe 19; VKM nr.138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar; VKM Nr.89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë"; VKB nr. 49, date 17.05.2019 "Për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit "Mbi zbatimin e programit për banesat me kosto të ulët në Bashkia Roskovec"", VKB nr. 68, datë 28.08.2020 "Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Për ndërtimin e banesave për strehim social, Roskovec", Shkresës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 194, prot, datë 11.01.2021 Kartela e Pasurisë së Paluajtshme, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e një ndryshimi të listës së pronarëve të shpronësuar bashkëngjitur vendimit Nr. 68, datë 28.08.2020 "Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "***Për ndërtimin e banesave për strehim social, Roskovec***".
- 2- Fondi për këtë qëllim do të përballohet nga buxheti i bashkisë për vitin 2021, fondi i caktuar në zërin "Shpronësime për interes publik".
- 3- Ngarkohet Komisioni i Shpronësimit për zbatimin e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 55 pika 6.

